



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



14-111/01- 107378 /20

Dt.03.07.2020

Në bazë të Nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), Nenit 5, pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, Nenit 4 dhe 5, të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik:

### KONKURS PËR PLOTËSIMIN VENDEVE TË PUNËS

#### DREJTORIA E ARSIMIT

Nr.	Niveli	Pozita	Vend ilirë/Zëvendësim	Numri i pozitave
1	ShFMU	Mësimdhënës/e për histori	Zëvendësim	2
2	ShFMU	Mësimdhënës/e për histori	Vend i lirë	2
3	ShML	Mësimdhënës/e për gjeografi	Zëvendësim	1
4	ShFMU	Mësimdhënës/e për gjeografi	Zëvendësim	2
5	ShML	Mësimdhënës/e për biologji	Zëvendësim	1
6	ShFMU	Mësimdhënës/e për biologji	Zëvendësim	1
7	ShFMU	Mësimdhënës/e për kimi	Vend i lirë	2
8	ShML	Mësimdhënës/e për fizikë	Vend i lirë	1
9	ShFMU	Mësimdhënës/e për fizikë	Vend i lirë	1
10	ShFMU	Mësimdhënës/e për fizikë	Zëvendësim	2
11	ShFMU	Mësimdhënës/e për edukatë qytetare	Zëvendësim	1
12	ShFMU	Mësimdhënës/e për edukatë qytetare	Vend i lirë	2
13	ShFMU	Mësimdhënës/e për matematikë	Vend i lirë	6
14	ShFMU	Mësimdhënës/e për matematikë	Zëvendësim	4

#### I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), **certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara të noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit, nuk do të merret parasysh;**

- Certifikata që nuk jeni nën hetime.
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (**nëse ka**).

## **II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor:**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT-it (UA Nr. 10/2018) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

### **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për histori në shkollë të mesme të ulët :**

- Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

### **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për gjeografi në shkollë të mesme të ulët dhe të lartë:**

- Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

### **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për biologji në shkollë të mesme ulët dhe të lartë:**

- Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

### **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për kimi në shkollë të mesme të ulët:**

- Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

### **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për fizikë në shkollë të mesme të ulët dhe të lartë:**

- Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

### **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për edukatë qytetare në shkollë të mesme të ulët:**

- Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

**Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për matematikë në shkollë të mesme të ulët:**

- Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Të gjithë kandidatët e kualifikuar për nivelin master arsimor 300 ECTS nga njësitë e tjera akademike, para datës 10.07.2015, i plotësojnë kriteret për t'u përfshirë në procedurat e rekrutimit.

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

**Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheqë 100 pikë apo deri në 50% të vlerësimit përfundimtar.**

**Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohet intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri 100 pikë apo 50% e vlerësimit përfundimtar.**

**Vlerësimi në intervistimin me gojë, bazohet në këto kriterë:**

**Njohuritë e Përgjithshme 25 pikë,**

**Aftësitë e përgjithshme dhe Personalitetit 35 pikë dhe**

**Njohuritë profesionale 40 pikë (Ku përfshihen përvoja e punës dhe kualifikimi profesional gjatë studimeve).**

**Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjidhen në pozitat e lartcekura**

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT.

Për intervistë do të ftohet ata kandidat të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test, intervistë, si dhe orari i intervistave publikohet në ëeb faqen e Komunës së Prishtinës <https://kk.rks-gov.net/prishtina/>(konkurset) dhe përmes e-mailit (sipas të dhënave në aplikacionin e kandidatit)

Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, nuk do të jetë domosdoshmërisht më datë 01.09.2020, por në varësi të lirimt real i vendit të punës në IEAA (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.).

Me këtë konkurs zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor shtator, 2020 – gusht, 2021 (komplet viti shkollor). Në rast të ndonjë nevoje eventuale për mësimdhënës/e në IEAA, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listave të publikuara me rastin e shpalljes së rezultateve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

## **Afati dhe mënyra e aplikimit**

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit me: **03.07.2020 deri më datën 17.07.2020.**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në komunë përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës.

**Nëse aplikohet për dy pozita (vend i lirë dhe zëvendësim), kandidatët duhet të dorëzojnë dy aplikacione të veçanta.**

**Vërejtje: Pas aplikimit, kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme për fazat e tjera të procedurave të konkursit.**